



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I DËGJIMIT PUBLIK NË KOMISIONIN PËR ZHVILLIM EKONOMIK, ...**  
**I MBAJTUR MË 10 PRILL 2019**

**SA JAVNE RASPRAVE U KOMISIJU ZA EKONOMSKI RAZVOJ, ...**  
**ODRŽANE 10. APRILA 2019. GODINE**

**PRILL - APRIL**  
**2019**

**Mbledhjen e drejtoi kryesuesi i Grupit Punues, z.Dardan Sejdiu.**

*Dëgjim publik për Mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për energjinë elektrike*

**KRYESUESI:** Përshëndetje të gjithëve,

Po e fillojmë dëgjimin publik,

Të nderuar pjesëmarrës,

Përfaqësues të institucioneve,

Palët e interesit,

Përfaqësues të shoqërisë civile, media,

Mirë se keni ardhur në këtë dëgjim publik i cili po organizohet nga Grupi i Punës për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjit për energji elektrike.

Ne si grup i punës në bashkëpunim me Institutin INDEP, kemi kërkuar nga INDEP-i që të bëjë një hulumtim të pavarur për nevoja të grupit punues edhe tashmë e kemi këtë hulumtim dhe sigurisht që me institucionet që i zbatojnë këtë ligj përkatëse pra.

Jemi takuar edhe me zyrtarë të INDEP-it dhe po dua që para se të hap diskutimin dhe dëgjimin publik t'i theksoj sa të gjetura të këtij hulumtimi dhe po shpresoj që debatin mund ta orientojmë vetëm mbi Ligjin për energji elektrike dhe mbi zbatimin e të njëjtit.

Ligji numër 05/L-085 është ende në fazën e zbatimit të objektivave kryesore.

Dinamika e implementimit të plotë të Ligjit për energjinë elektrike sipas hulumtimit të INDEP-it po edhe sipas leximit tim personal është e ngadalshme dhe niveli i përmbushjes së pritjeve që derivojnë nga ky ligj, edhe sipas hulumtimit të INDEP-it, por përsëri pajtohem me këtë gjetje është i pakënaqshëm.

Zbatimi i Ligjit për energjinë elektrike kushtëzohet në masë të konsiderueshme edhe nga zbatimi i ligjeve të tjera të pakos së tretë të Legjislacionit Evropian në fushën e energjisë. Për shembull ngecjet që janë në zbatimin e dispozitave që kanë të bëjnë me tregun e certifikatave të origjinës në masë të madhe ndërlidhen me sfidat e implementimit të Ligjit për energji.

Tutje, liberalizimi i tregut siç është paraparë me ligj nuk ka ndodhur. Udhëzuesi për liberalizimin e tregut i hartuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji nuk po shoh përfaqësues nga ZRRE-ja këtu. A ka përfaqësues nga ZRRE-ja? Nuk paskan ardhur përfaqësues nga ZRRE-ja?

Edhe pse ky udhëzues për liberalizim të tregut i hartuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji parashihte një kohëzgjatje më të madhe të tranzicionit të tregut i njëjti nuk është implementuar sipas planit.

Rregullatori për konsumatorët industrial të tensionit 35 ka vendosur tri herë radhazi të bëjë shtyrjen e afatit të liberalizimit, ky edhe me kërkesë të odave dhe përfaqësuesve të biznesit.

Tutje, neni 5, mbi kushtet e përcaktimit të obligimit të shërbimit publik nuk është i qartë sa duhet, ndonëse neni e specifikon që vendosja e OSHP-së nuk duhet të pengoj hapjen e tregut.

ZRRE-ja së fundit ka hartuar një draft të OSHP-së me anë të cilës vendoset obligimi në emër të energjisë së furnizimit, sigurisë së furnizimit për të mbuluar kostot e ndërmarrjes së re të energjisë në KEK, e cila sipas leximit tim, por edhe të INDEP-it do t'i shfrytëzojë këto të hyra për t'i mbuluar kostot dhe fitimet e një kompanie në treg. Ne kemi kërkuar si deputetë për hir të informimit të opinionit dhe pjesëmarrësve në këtë debat në këtë dëgjim, kemi kërkuar një interpelancë me ministrin Valdrin Lluka në lidhje me themelimin e kësaj ndërmarrjeje publike, e po shpresoj shumë që këtë javë do ta trajtojmë.

Neni 8 nuk është zbatuar, rregullatori ende nuk e ka hartuar skemën e certifikatave të origjinës dhe këto certifikata nuk kanë filluar të lëshohen. Ky proces sipas INDEP-it është shumë i rëndësishëm për shkak se siguron që pjesëmarrësit në tregun e energjisë për energjinë e gjelbër që ata e blejnë dhe e ritë transparencën, megjithatë kjo dispozitë pra dispozita e certifikatave nuk është zbatuar.

Neni 9, mbi rezervat e obligueshme të lëndëve djegëse ka hasur në vështirësi të implementimit. Nuk ka pasur nivel të kënaqshëm të implementimit sidomos nga ana e Qeverisë dhe problemet të KEK kishte pasur në mbulimin e rezervës për shkak të procesit të shpronësimit ish-in raportuar vazhdimisht nga ana e KEK-ut. Por, dështimi për realizimin e rezervës nuk ka realizuar me veprime të shpejta nga ana e Qeverisë.

Neni 25, mbi përgjegjësitë e balancimit nuk është i zbatueshëm plotësisht deri në anëtarësimin e KOSTT-it në ENTSO-E. Në situatën e tanishme sipas INDEP-it por edhe sipas kuptimit ne që e kemi si deputet dhe anëtarë të grupit punues përkatësisht për veten po flas tash me që të tjerët nuk janë këtu KOSTT nuk ka qasje në tregun e balancimit dhe kjo krijon vështirësi edhe në arritjen e sigurisë së furnizimit edhe në humbje që i shkaktohen KOSTT-it. Këtu kemi përfaqësues të KOSTT-it besoj që mund të na flasin për nenin 25 pak më gjatë dhe më gjerë për zbatimin e tij.

Neni 30, flet për sistemet e mbyllura të shpërndarjes. Ky nen ende nuk ka gjetur zbatim në praktikë. Ndonëse nuk ka pasur asnjë kërkesë për licencim të tillë, ZRRE ende nuk e ka kompletuar bazën ligjore që e kërkon ky nen, pra neni 30.

E drejta për ndërrimin e furnizuesit sipas neni 36 të Ligjit për energji elektrike ende është vetëm një gjë në letër. Pra, ZRRE edhe pse ka licencuar shtatë furnizues de fakto tregu kontrollohet veç nga një furnizues. Në një situatë të tillë qartazi neni 36 nuk po zbatohet.

Neni 46, që flet për kërkesat kontraktuale gjithashtu nuk është zbatuar.

Përsëri ZRRE-ja ka bërë hartimin e modelit të kontratës dhe ai model nënshkruhet nga konsumatorët e rinj, ndërsa konsumatorët ekzistues nuk kanë nënshkruar në kontratë të tillë. Pra, për ta thjeshtëzuar konsumatorët ekzistues nuk kanë nënshkruar asnjë kontrata për furnizim, thjeshtë kanë vazhdua me pagua faturat. Ndërsa kushdo që e fillon si konsumator i ri i epet një kontratë dhe mendoj që kjo është një obligim që nuk e ka krye operatori, ndonëse ekziston një model i kontratës i hartuar nga ZRRE-ja.

Neni 49, mbi konsumatorët në nevojë ende nuk është zbatuar. Qeveria sipas këtij neni është dashur të krijojë një fond për konsumatorët në nevojë, por kjo nuk është realizuar.

Neni 48, neni 53 dhe 54, nuk janë të harmonizuar me Ligjin për mbrojtjen e konsumatorit dhe mungesa e harmonizimit ka të bëjë me të drejtën për kompensim në rast të mosmarrjes së shërbimit, e që lidhet me informim të drejtë e qartësi në faturim.

Këto janë disa nga problemet që i gjeni edhe në raportin e përgatitur nga INDEP po gjithashtu edhe disa nga çështjet që ne si grup punues i kemi identifikuar gjatë trajtimit të Ligjit për energji elektrike.

Unë tash e hapi debatin dhe kërkoj me mirësjellje me aq sa mundemi që secili prej juve para se ta merr fjalën të prezantohet dhe të cekni këndë e përfaqësoni me që kjo na duhet për procesverbal. Pra, të kuptojmë brengat e secilës palë në mënyrë të drejtë dhe në mënyrë të saktë.

Edhe një herë faleminderit që keni gjet kohën institucioneve përkatëse, palëve të interesuara, organizatave të shoqërisë civile, qytetarëve që janë këtu sot edhe mediave dhe po e hap debatin.

Fjala është e juaja.

**KADRI KADRIU:** Unë jam Kadri Kadriu, zëvendës-kryeshef ekzekutiv i KOSTT-it.

Me qenë se këtë raport unë personalisht nuk e kam dhe ndoshta kish qenë mirë më herët me pas në mënyrë që me pas ne më shumë përgatitje në lidhje me këtë takim, por megjithatë unë po flas në lidhje me problemet që janë në sektor që i shohim ne si KOSTT edhe të arriturat dhe vështirësitë që janë në implementimin e Ligjit të energjisë dhe zhvillimit në përgjithësi të sektorit.

Ne pas aprovimit të ligjit që ka qenë kërkesë e paketës së tretë, të gjitha institucionet të themi KOSTT-i ndoshta të themi edhe Zyra e Rregullatorit të energjisë ka punuar kryesisht me adaptimin e legjislacionit sekondar e cila derivon direkt si rezultat i ndryshimeve në Ligjin për energjinë elektrike.

Mund të themi që afati nëntë mujorë kryesisht janë përfshirë këto ndryshime në procedura metodologji të ndryshme që kanë qenë si reflektim i ligjit dhe të gjitha kërkesat e legjislacionit sekondar kanë qenë të përmbushura.

Pastaj, implementimi është një proces tjetër i cili natyrisht që ka edhe vështirësi tjera të cilat nuk lidhen direkt vetëm me atë që shkruhet në letër po me implementimin direkt praktik sepse disa prej problemeve janë që kërkojnë edhe kohë të implementimit.

Në vitin 2017, si rezultat ose si obligim i kërkesës ligjore për hapje të tregut Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka lëshuar udhëzuesen mbi hapjen e tregut ku disa prej principeve themelore kanë qenë që tregu me shumicë të rregullohet që do të thotë që prodhimi i energjisë elektrike t'i nënshtrohet ligjeve të tregut jo të jetë i rregulluar përmes Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe kjo ka ndodhë dhe si e tillë janë lëshua edhe mënyra se si të ecet ky proces hap pas hapi.

Ajo çka ka ndodhë mund të themi që aktualisht ne si KOSTT humbjet e energjisë elektrike të cilat i kemi obligim për me i mbulua si rezultat i licencës lëshuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë aktualisht i blejmë në treg dhe janë në përputhje të plotë me rregullimin e tregut që KOSTT-i duhet blerë këto humbje në treg.

Ne aktualisht kemi dy lloj të marrëveshjeve, një marrëveshje e kemi bilaterale nëpërmjet KEK-ut që e... një pjesë të humbjeve të energjisë dhe pjesën tjetër hapëm treg një ditë përpara dhe gjatë ditës që çdo ditë hapet edhe ankandit dhe ku tregtarët e ndryshëm japin oferta dhe oferta përzgjidhet sipas kostos më të lirë, kjo pra është tu ndodhë.

Aktualisht sa kam njohuri edhe KEC-i e bënë një gjë të tillë. Sa për informimin e juaj diku rreth mund të themi mbi 25% të energjisë elektrike sot në treg tregtohet sipas tregut të liberalizuar.

Kërkesë tjetër ka qenë certifikimi i KOSTT-it sipas kërkesës së Sekretariatit të Komiteteve të Energjisë dhe paketës së tretë, ajo ka ndodhë. Tani KOSTT-i është... e certifikuar sa për informimin e juaj plotësohen në regjion nuk janë të certifikime dhe ne jemi plotësisht në përputhje me paketën e tretë.

Hapja e tregut që ka qenë kërkesë ligjore po ashtu është kërkuar që një ditë përpara se... të kemi një treg të organizuar ose një bursë të energjisë kjo nuk ka ndodhë, jemi në proces.

Kosova dhe Shqipëria kanë nënshkrua memorandumin e mirëkuptimit që me bë tregun e përbashkët, arsyeja pse kemi dashtë të bëjmë një treg të përbashkët është sepse dy tregje janë tregje të vogla janë jo likuide nuk është një treg i maturuar jo vetëm në Kosovë po në gjithë regjionin dhe rritja e një tregu të tillë është konsiderua nga aspekti ekonomik shumë më përfitues dhe ku ka shumë më shumë tregtar, ku ka shumë më shumë gjenerues dhe ku ka shumë më shumë konsum dhe kjo jep mundësi që ky treg të jetë shumë më...

Po, ku kemi arrit me themelimin e tregut. Aktualisht pritet me u marrë vendimi i këshillit të ministrave.

Me qenë se ky treg do të themelohet në Shqipëri dhe një kompani e tillë do të nënshtrohet të gjitha ligjeve shqiptare dhe pritet themelimi i kompanisë dhe kjo pastaj merr procesin e vetë diku rreth një vit për me qenë operativ.

Pra, kjo është procesi të cilën ne jemi duke punuar por që ende nuk ka ndodhur.

Sa i përket hapjes së tregut, në Kosovë ka ndodhur edhe një diçka që është një progres i mirë. Mekanizmi balancues nga viti 2017 është në operim.

Procedura për ndërrimin e furnizuesit po ashtu është në fuqi dhe mund të bëhet, por u përmend edhe këtu aktualisht, fatkeqësisht ndoshta që operon vetëm një furnizues dhe ajo e ka 100% të furnizimit. Arsyeja pse furnizuesi nuk vinë sigurisht ato janë më shumë çështje furnizuese sepse ata nuk kanë arritur me gjet konsumator dhe me ju afrua çmime të volitshme për të cilën ata konsumatorë kanë interes me kalua prej atij konsumatori në konsumatorin tjetër. Mirëpo procedura ekziston dhe mund të ndodhë.

Çka është i rëndësishëm mekanizmi balancues? Për hapjen e tregut gjithsesi duhet me qenë në fuqi mekanizmi balancues sepse energjia elektrike është një produkt shumë specifik i cili prodhimi dhe konsumi duhet të jenë në çdo moment kohor të balancum. Pra, nuk është një produkt i cili mund të ruhet dhe pastaj të përdoret atëherë kur ne mundemi, por duhet të jetë çdo herë në balancë. Dhe ky tregu balancues e mundëson që këto diferenca që ekzistojnë në mes të prodhimit dhe konsumit në kohë reale të balancohen nëpërmjet operatorit të sistemit dhe pastaj të gjithë tregtarët dhe pjesëmarrësit në treg t'i paguajnë kostot e tyre. Pra, ky është një hap i cili e mundëson tregun një ditë përpara dhe tregun... për të qenë funksional.

U përmend këtu që ka gjashtë furnizues, është e vërtetë domethënë është vetëm një furnizues që operon. Tani duhet sigurisht që shikohet pse nuk ka ndodhë kjo, cilat janë barrierat sigurisht debate të tilla i qesin në pah po ajo çka e dëgjova edhe sot e kamë dëgjua edhe më herët se Rregullatori i Energjisë ka bërë shtyrjen e afatit të hapjes së tregut në nivele 35 kw si dhe palët e

interesit praktikisht, të cilët operojnë në treg kanë kërkuar që një çështje të tillë sepse duket se është më profitabile me ndejtë kësisoj se sa me dal në tregun e hapur. Unë i di pengesat, ne kemi një pengesë themelore që është operimi i KOSTT-it si zonë rregulluese dhe qasja e Kosovës në kapacitet tona... ajo është një barrierë themelore që e pengon hapjen e tregut në Kosovë. Prej formimit ... se marrëveshje ka ... nuk vjen në implementim edhe po ta themelojmë tregun me Shqipërinë, Kosova e ka vështirë me marrë pjesë në atë treg. Pra, ne mund të jemi pjesëmarrës, por implementimi i atij tregu do të jetë i vështirë. Pra, është një barrierë që është si me thënë barrierë në gjithë elementet e zhvillimit të sektorit të energjisë në Kosovë.

Pra, element tjetër i rëndësishëm është mbështetje e burimeve të rinovueshme të energjisë. Tregu i energjisë elektrike dhe Ligji i energjisë elektrike i ka definuar qartë se Kosova duhet t'i japë prioritet integritit në burime të rinovueshme të energjisë. Mendoj që këtu është bërë një lëvizje përpara, janë të definuara marrëveshjet që ato si vihen para fuqisë ... ndërmjet operatorit tregut dhe kompanive që janë të interesuara me marrë pjesë në ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga prodhimi i energjisë, nga burimet e rinovueshme. Është formuar Fondi i burimeve të rinovueshme të energjisë, kanë prioritet në dispeçim domethënë ata që prodhojnë energji nga burimet e rinovueshme nga ata merret ajo energji dhe të gjithë furnizueseve në Kosovë ju ndahet në mënyrë proporcionale. Kështu që domethënë, kjo është krejt legjislacioni po flas për burime të rinovueshme. Krejt legjislacioni ekziston i cili e mundëson që me pas nxitje për investim në burimet e rinovueshme të energjisë.

Për informimin e juaj aktualisht kemi kërkesa rreth 500 megavat në kyçjen në transmetim që një pjesë e tyre janë pjesë e skemës mbështetëse dhe pjesa tjetër sigurisht do të jenë në skemat e reja që do të ndërtohen nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë pastaj a do të jetë me mbështetje apo do të jetë tërësisht në treg nuk e dimë, por pritet me u zhvillua dhe në këtë drejtim vitin e kaluar kemi pas integrimin e burimit të parë me 32 megavat Kitka që është një kapacitet goxha i madh nga këto burime dhe diku rreth 100 megavat kemi kapacitete të prodhimit të energjisë nga hidrocentralet e vogla, nga burimet fotovoltaike e kështu me radhë. Të gjitha këto që i përmenda vetëm për informimin e juaj është me tregua çka ka pas edhe lëvizje edhe cilat janë progreset edhe vështirësitë në implementin e Ligjit të energjisë dhe u përmend këtu edhe çështja e balancimit në tregun e energjisë elektrike, është e vërtetë kjo ne kemi problem me balancua sistemin. Një prej problemeve është marrëveshja KOSTT- ENTSO-E.

Ne kemi investuar në një projekt që quhet “low frequency control Kosovë - Shqipëri”, i cili është paraparë që energjinë balancuese ne me e marr prej Shqipërisë ose me e nda pjesë edhe nga Shqipëria, po atë nuk po mundemi me e fut në operim për shkak të kësaj marrëveshje.

Elementi tjetër është që kemi pasur një vendim i cili është i Avokatit të Popullit, i cili ka thënë që energjia që konsumohet nga konsumatorët e Veriut nuk duhet tu vendoset në tarifa konsumatorëve tjerë. KOSTT-i ka qenë përgjegjës në vitin 2017 me i mbulua humbjet e

energjisë në Veri të Kosovës dhe me këtë ligj neve na u është ndaluar dhe praktikisht ajo energji që është konsumuar prej atyre konsumatorëve është si energji e ... të cilën është aktualisht duke e mbuluar ... Evropës Kontinentale. Dhe për këtë problem ne kemi pasur edhe debate me ENTSO-E dhe ka qenë një temë që pothuajse një vit merremi me këtë i cili është aktualisht në kundërshtim edhe me këtë ligj, natyrisht. Dhe, po ashtu pamundësia në qasje të kapaciteteve transmetuese dhe tregun regional e bën KOSTT-in e vështirëson nga aspekti ekonomik me e balanca sistemet, sepse krejt kjo ndërlidhet me marrëveshjen e kycjes së KOSTT-in me ENTSO-E. Kjo është shkurtimisht pastaj në qoftë se ka pyetje konkrete ne jemi këtu. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti Kadriu! Dy informacione shtesë, e para analiza e INDEP-it është bërë për nevoja të komisionit. ne si komision jemi duke u angazhuar që monitorimin ose mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve ta si me thënë formatizojmë në një proces i cili bëhet standard për të gjitha komisionet tjera për aq sa mundemi me dhënë një mënyrë për mbikëqyrje të zbatimit të ligjit dhe është për nevoja të komisionit, por nëse ju jeni të interesuar ne mundemi me e shpërndarë edhe për juve pa asnjë telashe. Por, është dokument që është bërë për nevoja dhe me kërkesë të komisionit.

E dyta, dua të falënderoj përfaqësuesin nga ZRRE-ja që është këtu me ne. është me rëndësi të ju kemi këtu, ju faleminderit që jeni këtu. desha këto dy sqarime t'i bëj para se të vazhdojmë. Kushdo që e do fjalën, ju lutem, edhe një herë vetëm se prezantohuni.

**LUAN MORINA:** Unë jam Luan Morina, drejtor i Departamentit të Energjisë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Faleminderit, kryesues për ftesën!

Përsëritës të gjithë të pranishmit,

Edhe unë jam i mendimit me atë që u specifikua nga Kadriu që në funksion të implementimit të Ligjit të energjisë elektrike do duhej të kenë konsideratë edhe ligjet tjera, kornizat tjera ligjore. Unë listova të gjitha këto është mirë me e pas pasur ne raportin, së paku këto shqetësimet dhe ne me ardhë me formë të shkruara, mirë, ne do t'i dërgojmë edhe me shkrim nëse ka nevojë prapë sqarime shtesë për këto dy pikat, së paku që lidhen me Ministrinë, që është te rezervat e lëndëve djegëse dhe tek skema mbështetëse për kategoritë e atyre që janë në nevojë dhe kanë nevojë për mbështetje. Edhe pse ajo skemë do duhej të iniciohej nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, megjithatë ne do ta japim kontributin. E di që në baza vjetore ndahet një buxhet për mbulimin e kësaj kategorie.

Sido që të jetë në funksion të implementimit të ligjit edhe tek pjesa e burimeve të ripërtërishtme tashmë e kemi edhe Ligjin për investimet strategjike e cila ... me mbështetje i jep investime në fushën e burimeve... implementimi i atij ligji është në ... gjithashtu edhe me obligimet kontraktuale të dhëna mbi bazën e nënshkrimit të ... pra në funksion të arritjes së caktuar ... pjesa tjetër e sektorit, sektori i energjisë është bajagi i decentralizuar dhe vendimet në funksion të



hapjes së tregut, të krijimit të konkurrencës në treg me dhënien e licencave për furnizuesit e ri, gjithashtu janë termat e ... është kryesisht për njësi që lidhen me për njësitë e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë është mirë që Afrimi është këtu, ka qenë një ndër ... bordi apo edhe drejtori ... megjithatë e kemi Afrimin. Besoj që do të na jep informacion pak më të detajuar në këtë drejtim.

Informacioni i fundit i Zyrës së Rregullatorit për konsumatorët e kategorisë 35 dhe vendimi i parë kur është bërë hapja e tregut për konsumatorët e mëdhenj ne kemi qenë pjesë e disa debateve dhe kemi parë shqetësimet që një pjesë e konsumatorëve të mëdhenj kërkon me e hapë tregun, një pjesë kërkon me e shty hapjen e tregut për shkak të mos gatishmërisë tyre për me u fut në raporte kontraktuale me furnizuesit, megjithatë nëse nuk kemi konkurrencë brenda vendit pra të gjithë ata që kanë marrë licenca dhe vetëm licenca në formën e letrave nuk ushtrjnë funksionin ... të kontratave që mund të kenë terma të furnizimit dhe kemi limitim në tregun regional besoj që ka me qenë sfidë edhe për vitet në vijim. Tash, edhe ky element mund të jetë, janë shqetësime të ngritura në vazhdimësi jo vetëm nga ne, por edhe nga të gjithë të tjerët, megjithatë kemi një dokument strategjia e energjisë i cili i sheh kapacitetet e nevojshme, mirëpo format e kontratës, dizajnimi i kontratës mund të jenë gjithmonë të ndryshme. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Faleminderit për komentet në lidhje me dy çështjet e ngritura sa i përket MZHE-së. Zotëriu e ka kërkuar fjalën.

**ARBËR KRASNIQI:** Jam Arbër Krasniqi, këshilltarë i përgjithshëm, e përfaqësoj kompaninë KEDS dhe KESCO.

I nderuar zoti Sejdiu, dhe të nderuar të pranishëm, ashtu siç është kërkuar edhe me letrën e dërguar, më datën 3 prill, ne kemi përgatit disa komente në lidhje me zbatimin e Ligjit për energjinë elektrike. Përkundër faktit që nuk kemi pa shqetësimet apo këto pikat që janë duke u mbledh, ne i kemi edhe disa shqetësime, që kishim mund të përgjigjemi me shkrim më mirë. Ne si kompani kemi edhe disa shqetësime që ballafaqohemi me këtë Ligj, siç është neni 61 të shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë elektrike, ku gjatë viteve të kaluara jemi përballur me sfida për shkak të legjislacionit ekzistues në fuqi dhe varësisë së procesit operacional nga institucionet e tjera. Në këtë kontekst dëshirojmë të paraqesim vështirësitë e hasura në lidhje me Ligjin për energji elektrike, respektivisht nenin 61 që është për shfrytëzimin e paautorizuar të konsumit të energjisë elektrike, ku kërkojmë edhe mbështetjen nga Kuvendi për gjetjen e një zgjidhje optimale. Përveç kësaj ne dëshirojmë të theksojmë se menjëherë pas miratimit të këtij ligji kemi kërkuar zyrtarisht mbështetje nga Rregullatori për çështjen e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, duke marrë parasysh seriozitetin e këtij problemi akoma jemi në zgjidhje të qartësimin të kësaj çështje.

Statistikat e KEDS në lidhje me humbje të energjisë në sistemin e shpërndarjes për shkak të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike tregojnë se kompania përballet me humbje të mëdha për të mbuluar humbjet komerciale. Kjo çështje ka qenë një barrë për shumë vite për konsumatorët që paguajnë mirë duke ditur faktin se ata duhet ... për humbjet në rrjetin e shpërndarjes. Në këtë drejtim KEDS shpreson që Kuvendi i Kosovës do të na mbështet në reduktimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes duke marrë parasysh propozimet tona.

Edhe pse KEDS bën përpjekje për të identifikuar konsumatorët që shfrytëzojnë në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike dhe këto veprime i largojmë. Shumë prej tyre vazhdojnë të keqpërdorin energjinë elektrike dhe veprimet ligjore të ndërmarra ndaj tyre kanë provuar të jenë si humbje kohe apo efekti minimal për shkak se janë përsëritës të kësaj vepre. Për fat të keq legjislacioni aktual në fuqi i lejon konsumatorët e tillë të pandershëm për ta përdorur këtë boshllëk ligjor, ashtu që të shfrytëzojnë energjinë elektrike dhe të mos paguajnë për atë dëm deri nga forma e plotfuqishme e një vendimi gjyqësor. Më poshtë mund, nëse është në interes të kryesuesit, mund t'i përshkruajmë disa raste kështu si statistikë. Në baza ditore KEDS identifikon konsumatorët, të cilët kanë keqpërdorur energjinë elektrike më shumë se një herë.

Gjatë vitit 2016, kemi pasur 500 raste të identifikuara të personave përsëritës apo recidivist siç i quajmë ne në gjuhën juridike që u gjetën duke e keqpërdorë energjinë elektrike. Gjatë vitit 2017 kanë qenë 666 raste, ndërsa në vitin 2018 kanë qenë 961 raste të personave që janë përsëritës të veprës të keqpërdorimit të energjisë elektrike apo marrjes së paautorizuar. Në vitin 2016 nga 9 mijë konsumatorë që u gjetën duke e keqpërdorur energjinë elektrike më shumë se 1 mijë e 833 janë gjetur direkt të kyçur në rrjetin e shpërndarjes. Në vitin 2017 9 mijë e 782, u gjetën duke keqpërdorur energjinë elektrike më shumë se 829 u gjetën direkt të kyçur në rrjetin e energjisë. Dhe gjatë vitit 2018 nga 9 649 kontrole, më shumë se 1 139 janë gjetur të kyçur direkt.

Për të dyja rastet e përshkruara që i precizova më herët, kërkesa e KEDS-it për Kuvendin e Kosovës është të mbështetë kompaninë tonë për të krijuar një mekanizëm brenda legjislacionit për zbatimin e një disipline të pagesës për të ndaluar përdorimin e tillë të paautorizuar të energjisë elektrike. Pavarësisht nga fakti se shkyçja është mjet i fundit për të zbatuar disiplinën e pagesës së konsumatorëve që keqpërdorin energjinë elektrike, KEDS është i gatshëm që në mënyrë efektive të shfrytëzojë këtë mjet për të parandaluar konsumatorët individual të vazhdojnë të përdorin energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar.

Kemi vështirësi edhe në zbatimin e nenit 53, paragrafi 2, pajisjet matëse që është në ligj. Ku, OSSH-ja po ballafaqohen me pengesa në përmbushjen e të drejtës së saj dhënë përmes nenit 53, pika 2, për të pasur qasje deri në pikën matëse. Nëse OSSH-ja nuk mund të ketë qasje në pikën matëse në kohën e inspektimit, provat dhe faktet për keqpërdorim të mundshëm mund të shmangen për konsumatorët, për arsye që e ndalon qasjen dhe e shmang veprimin me të cilin e ka bërë deri më tani dhe është pothuajse i pamundshëm zbulimi i tij apo i saj. Në nenin 46, siç u

cek në të gjeturat e INDEP-it, për interesimin tuaj, ne vazhdimisht dërgojmë ftesa për nënshkrimin e kontratave. Siç e dini edhe ju mirë, KEDS edhe për të vjetrit, sepse KEDS ka trashëguar një bazë të shënimeve nga KEK-u, në kohën e privatizimit dhe në të është vërejtur se ka mungesa të mëdha të shërbimeve siç është njoftimi jo me dhjetëshifror me pak shifra, te emrat ka shkronja të tjera, jo të emrave. Si fillimisht, kemi filluar duke i dërguar ftesa që të paraqiten në sportel të përkujdesjes së konsumatorëve në afat prej 15 ditëve që të nënshkruajnë kontratën dhe numri i tyre është i madh. Te konsumatorët që paraqiten për ankesa. Gjithashtu edhe te konsumatorët që paraqiten në sportele për ankesa, për anketim, që kanë ndonjë shqetësim lidhur me kutitë, edhe aty kërkohet që verifikimi i tyre të bëhet me... konsumator, a ka nënshkruar kontratë apo jo.

Por, zbatimi i këtij neni në kushtet ekzistuese në tregun e energjisë në Kosovë, ka krijuar vështirësi në funksionimin e përditshëm të operatorit të sistemit të shpërndarjes. Duke marrë parasysh se neni aktual nuk e definon qartë se ky duhet të zbatohet apo do të krijojë probleme duke shkuar përpara si dhe të krijojë mundësi për keqpërdorim që rezulton në humbje ekonomike për dy të licencuar dhe konsumatorët.

Ne e vlerësojmë këtë takim që është ftuar, sepse ky dëgjim është për interes të madh edhe për interesin e përgjithshëm.

**KRYESUESI:** Ju faleminderit për kontributin dhe për ndarjen e shqetësimeve.

Meqë nuk kam qasje në statistikë, për informacion, po më intereson, në fakt deformim kjo punë e jona, për krahasim, thjesht krahasim, as nuk po e mbroj, as nuk po e mbështes recidivistin që të mos keqkuptohem, por po më interesoj të dije sa është numri total i konsumatorëve në vitin 2016, pra që e keni ju, edhe numri total i konsumatorëve në vitin 2018, që i shërbeni, totali i konsumatorëve, a janë 300 mijë a janë 500 mijë a sa janë? 2016 dhe 2018? Për krahasim po më vyen të shoh ky recidivizëm a po është trend në ngritje, edhe si përqindje e totalit të konsumatorëve.

**ARBËR KRASNIQI:** Saktësisht në vitin 2019 janë 600 mijë. Rreth 600 mijë. Me statistikat që i kemi nga viti në vit, përafërsisht 25 mijë deri 30 mijë të rinj janë shtuar.

**KRYESUESI:** E a e keni informacionin kur është bërë privatizimi i distribucionit, sa ka qenë numri i konsumatorëve. D.m.th. mund të konkludojmë që numri i konsumatorëve për periudhën në fjalë është rritur për 200 mijë.

**ARBËR KRASNIQI:** Përafërisht.

**KRYESUESI:** Ok, faleminderit! Thjesht për ta pasur. 150 mijë. Veç ta kemi si pikë krahasuese, sepse po i referoheni 800 rasteve në 550 mijë konsumatorë.

**RUDINA HEROI-PUKA:** Dardan, më fal, se më duhet të kyçem. Unë jam Rudina, jam prej KESCO-s. 800 raste janë raste recidiviste, po nuk janë vetëm këto raste. Veç për sqarim domethënë.

**KRYESUESI:** Unë po flas, unë tash prapavijën e kam në financa. Edhe ne në banka kur punonim, klientët e këqij i klasifikonim dhe ku ishte një përqindje e caktuar, Banka Qendrore nuk bënte shumë telashe, sepse është përqindje e vogël në krahasim me numrin total dhe ndonëse janë recidivistë dhe ndonëse duhet të trajtohen, nuk besoj që impakti i tyre në qarkullim dhe në faturim është i jashtëzakonshëm. Është i madh, por nuk është diçka që besoj Kuvendi i Republikës së Kosovës mund ta trajtojë me ndonjë amendamentim të ri të ndonjë ligji. Besoj që gjykatat, sepse...

**ARBËR KRASNIQI:** Mendoj që ndihma që mund të jepet në këtë paragraf, ose nenin 61 është që të krijohet një mekanizëm ku u ndalohet qasja, apo t'u ndërpritet qasja, mos të mundet ai të rikyçet ai pa të drejtë, dhe pse është shqetësuese ky numër, është sepse ata nuk janë në proces të vitit, por raste të tyre ndodh që janë 22 herë brenda muajit. Kjo është shqetësuese. Prandaj, ne kemi kërkuar që të krijohet mekanizëm për ndalimin e tyre.

**KRYESUESI:** A keni idenë se qysh duket ai mekanizëm? Pra, dëgjimi publik e ka edhe këtë kuptim, të vihet me propozime.

**ARBËR KRASNIQI:** Besoj që duhet të ulemi të bisedojmë, të punohet në atë drejtim me inxhinierët e kësaj lëmie.

**RUDINA HEROI-PUKA:** Një prej propozimeve që e kemi diskutuar me ZRRE-në, ka qenë që në qoftë se është një konsumator i cili disa herë rikyçet në mënyrë të paligjshme, atëherë të na jepet e drejta ta shkyçim se ai po kyçet ilegalisht.

**KRYESUESI:** Veç për ta kuptuar edhe një herë për mua si kryetar i këtij grupi punues. Falënderoj edhe kryetarin e Komisionit që na u bashkëngjiti. Tash unë e bëra një kalkulim të shpejtë këtu sa për qind e konsumatorëve jemi duke folur, është as 0.2 për qind. Pra, nuk duhet ta trajtoni në mënyrë pak më..

**ARBËR KRASNIQI:** Numri i keqpërdorimeve është shumë më i madh. Këtë statistikë që e kemi bërë është veç për numrat që janë të recidivistëve. Nëse e marrim që ai ka keqpërdorur një herë.

**KRYESUESI:** Nuk jam duke i mbrojtur, veç çka po dua të vendos në kontekst të diskutimit është volumi i të hyrave që krijohet nga një situatë në të cilin jeni ju që është monopol natyror, me diku 600 mijë konsumatorë. Edhe statistikisht po e trajtoj.

**ARBËR KRASNIQI:** Edhe në aspektin ligjor, edhe në bazë të ligjit, numri është shumë më i madh i keqpërdoruesve për herën e parë. Këto numra që i kemi shfaqur janë ata që janë përsëritës, janë recidivistë.

**KRYESUESI:** Cilat janë të hyrat mujore përfaqësues të KEDS-it për 550 mijë konsumatorë.

**ARBËR KRASNIQI:** Sot kemi ardhur për të biseduar lidhur me zbatimin e ligjit për këtë çështje.

**KRYESUESI:** Dakord, po i paraqitni humbjet e mëdha të KEDS-it e të KESCO-s, e për mua si deputet është me rëndësi të kuptojë sa janë ato humbje.

**ARBËR KRASNIQI:** Nëse kërkohet, ne përgjigjemi me shkrim për këtë çështje.

**KRYESUESI:** Dakord, veç si informacion.

**ARBËR KRASNIQI:** Po si informacion.

**KRYESUESI:** Rudinë, veç ta shpjegoj mendimin, që të mos keqkuptohem, nuk e kam as intencën, por nëse themi në dëgjim publik se humbjet janë të mëdha, atëherë këtë duhet ta vendosim në një masë krahasimore. Humbje të mëdha, në krahasim me çka? Me pritjet e planit të biznesit tuaj, apo me totalin e të hyrave tuaja? Ne asnjërin s'e kemi si informacion. Pra, duhet t'i besojmë informacionit që jepni pa pasur numra specifikë, konkretë. I vetmi numër specifik që ma dhatë i nderuar sot është që janë 1139 recidivistë të kyçur direkt në rrjet në vitin 2018. Dhe unë pyeta sa është numri i konsumatorëve, ju më thatë mbi 500 mijë. Këta dy numra unë i kam për krahasim. Nuk e kam me intencë, thjeshtë ta kuptoj e kam.

**RUDINA HEROI-PUKA:** Veç po dua të plotësoj, se nëse e këqyrim aspektin e numrave, ndoshta ke të drejtë, por nëse e shohim në aspektin financiar është diçka tjetër. Nuk e di saktë për momentin sa është pjesa financiare e recidivistëve, por në baza vjetore, faturimi për rikthim të humbjeve që ne e quajmë është diku rreth 50 milionë, ndërsa të hyrat e lejuara për furnizuesin që i mbulon të hyrat edhe të gjithë sektorit janë 240 milionë, që i bie diku është 20 për qind e të hyrave të sistemit jemi duke folur në këtë rast.

**KRYESUESI:** Veç ta kuptojmë 240 milionë i keni të hyrat vjetore ju.

**RUDINA HEROI-PUKA:** Krejt sistemi, se ne si furnizues i bartim edhe të hyrat, i paguajmë edhe ndërmarrjet e tjera.

**KRYESUESI:** Dakord, ju faleminderit, por besoj që me shkrim na jepni informacionin për të hyrat vjetore që i keni prej shitjes dhe shpërndarjes së rrymës.

**RUDINA HEROI-PUKA:** Këto janë publike edhe në raportet e ZRRE-së, raportet vjetore të ZRRE-së.

**KRYESUESI:** Dakord, faleminderit.

**KADRI KADRIU:** Unë sa e kuptoj, veç po dua të ndihmoj këtu. Ju keni bërë test 9 900, mostra dhe prej tyre kanë dalë 1 100 që janë kyçje ilegale. Do të thotë kjo është 10 për qindëshi. Nuk është e vogël. 10 për qind e mostrës. Pra, nëse ishin shkuar në 100 mijë konsumatorë, këtyre u dalin që janë 10 mijë konsumatorë janë kyçur ilegalisht. Kështu del. Kështu që desha të them që kjo pastaj.

**KRYESUESI:** Të ndihmoj edhe unë pak në këtë analizë. Është mirë të shihet mostra, është mirë të shihet shpërndarja gjeografike për të mund të vihet te një konstatim bash shkencor për këtë punë. Meqë me mostra e me këso gjëra merremi ne në politikë goxha shumë, edhe demografia është e rëndësishme, edhe shpërndarja regjionale është e rëndësishme, po gjithsesi e kam të qartë brengën, dhe e kemi parasysh.

Dikush tjetër? Nga Zyra e Rregullatorit.

**AFRIM AJVAZI:** Po më duket më erdhi radha të diskutoj pak. Unë jam Afrim Ajvazi, udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe të Licencimit në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë.

Përshëndetje të gjithëve!

Është mirë që jemi shumica e aktorëve këtu, me të cilët ky ligj merret, dhe përgjegjësitë e të cilëve ky ligj i përcakton dhe për t'i parë nga këndvështrimi i secilit aktor, ku janë vështirësitë në zbatimin e të drejtave dhe përgjegjësi të tyre. S'po e shoh KEK-un që është një prej akterëve kryesor, shtyllë në zbatimin e këtij ligji, pra shtyllë posaçërisht në hapjen e tregut dhe KEDS, KOSTT. Ndoshta kishte qenë mirë edhe furnizuesit aktualë të cilët janë të licencuar në Zyrë të Rregullatorit për Energji, po nuk po mund të hyjnë në aktivitetin e furnizimit për t'i parë edhe vërejtjet e tyre, brengat e tyre. Pse cilat janë vështirësitë që ata janë duke mundur të merren me aktivitet të furnizimit edhe pse e kanë licencën, e kanë marrë licencën.

Tash disa fjalë për hapjen e tregut. Ne si Zyrë e Rregullatorit për Energji kemi qëllimin e kemi pasur të krijohen të gjitha parakushtet për funksionimin e një tregu të hapur ose konkurrues të energjisë në Kosovë. Edhe në këtë drejtim, kemi hartuar tërë kornizën rregullative, e cila është e domosdoshme. Kemi identifikuar numrin e konsumatorëve, ata që quhen, që mbrohen nën shërbimin universal dhe e kemi ngarkuar KESCO-n me obligim të shërbimit publik, që këta konsumatorë të jenë të mbrojtur. Kemi nxjerrë, kemi caktuar obligim të 'last resort supplier' që quhet në anglisht ose furnizuesi i fundit. Janë rregulla që i përmendi Kadriu për ndërrim të konsumatorëve. Kemi licencuar shtatë tash po bëhen furnizues të rinj, përveç KESCO-s, në mënyrë prapë po them që të fillojë të funksionojnë tregu konkurrues i energjisë elektrike në Kosovë. Udhëzuesin e kemi hartuar, ku i kemi përcaktuar dinamikat e hapjes së tregut vit pas viti. Fatkeqësisht këtë vit kemi planifikuar që në tregun e lirë të imponojmë edhe konsumatorët komercialë, të kyçen në 35 dhe 10 kilovolt. Pas shumë debateve dhe diskutimeve në të cilat ne si Departament s'kemi marrë pjesë, po departamentet e tjera të ZRRE-së, u insistua që ky proces të shtyhet për 35 dhe 10. Kemi pasur debate ne brenda Zyrës së Rregullatorit për Energji, por aktorët relevantë në tregun e energjisë, konsumatorët presin të kyçen në këtë nivel të tensionit. Kanë insistuar që të shtyhet ky proces deri 2020-2021. I jemi drejtuar edhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Kemi vërejtje edhe prej tyre. Me siguri edhe do të ndërmarrin masa ndaj Zyrës së Rregullatorit për Energji, ose Kosovës e cila është si palë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Pra këto janë rrethanat. Pra kemi pasur debate edhe Zyra.

Tani, disa nga vërejtjet janë reale për shkak se edhe pse i kemi krijuar parakushtet për funksionim të tregut, nuk ka rezultate. Ne kemi pasur edhe takime me furnizues të cilët janë të licencuar, tregoni cilat janë arsyet pse nuk po hyni në tregun e energjisë. Kostoja e lartë dhe ajo çështja politike që e përmendi Kadriu, për të bërë alokim të kapaciteteve, ata duhet të aplikojnë krejt diku tjetër, dhe krejt kjo derisa ta sjell energjinë elektrike në Kosovë e rrit koston e tyre dhe nuk janë konkurrues. Kjo është arsyeja. Një prej arsyeve shtyllë.

D.m.th. krejt këto çështje, s'po e përmendi atë çështjen e që e tha Kadriu që krejt funksionimi i tregut në Kosovë po lidhet në njëfarë forme me rolin e KOSTT-it që e ka si zonë rregulluese. Definitivisht po. Kjo është sa i përket tregut të hapjes së tregut të energjisë. Për BRE-të ka rezultate të mira, me gjithë vërejtjet që i kemi prej akterëve të ndryshme. Dikush nuk lejon termocentralin, dikush i kundërshton BRRE-të, nuk i kemi pak qëndrimet e qarta edhe si institucione, edhe si akterë në këtë drejtim. Së fundi e kam pasur një debat për BRE-të, jo po e shkatërroni ambientin, hidrocentralet, tjetri thoshte se po e ndotni ambientin me termocentrale. Nuk po e dimë se kah jemi duke shkuar si institucione. Fatkeqësisht ne kemi rol kyç si zyre në këtë proces, por edhe ne po biem nën ndikim të këtyre kritikave të cilat po i marrim kohë pas kohe.

Ka rezultate. Sa për ilustrim themi se sot janë 13 gjeneratorë që operojnë në Kosovë, ndërkaq pritet që edhe 27 të tjerë të nderohen këtë vit dhe vitin e ardhshëm. Po i përdor numrat qëllimisht

dhe jo kapacitetet. Pra, domethënë që do të ndërtohen 40 gjeneratorë në këtë shtet, po më duket se jemi lider në rajon. Kapaciteti është diçka tjetër ngase i kemi burimet e vogla. Kemi lumenj të vegjël, po ata po mundohemi t'i maksimalizojmë. Domethënë pritet që në fund të 2020-ës të jenë 40 gjeneratorë në operim në Kosovë. Nuk e di se a ka ndonjë shtet në rajon në të cilin janë ndërtuar gjeneratorë të tillë brenda një periudhe kaq shkurtër.

Prapë po them se nuk po flas për kapacitet, se një hidrocentral në Shqipëri ndërtohet 50 MGW sa 20 në Kosovë, por si lëndë si aplikacione ka rezultate.

Me qëllim që të jap kontribut këtij diskutimi mund të them se si zyre kemi pasur sukses të hatashëm në certifikimin e KOSTT-it, me gjithë kundërshtimet që kanë ndodhur. Nuk e di a e raportoi Kadriu, me gjithë lobimin të cilin e ka bërë ana e kundërt andej, por patëm sukses dhe jemi shteti i dytë në këtë pjesë i cili ka pasur sukses që të certifikojë operatorin në sistemin e transmisionit.

Me fjalë të tjera, i kemi legjitimuar kufijtë energjetik të Kosovës, pra me këtë proces që e kemi përfunduar si zyrë në bashkëpunim me KOSTT-in. Pra, është një rezultat i hatashëm për tregun e energjisë në Kosovë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit shumë! Po ua jap fjalën nëse nuk ka të tjerë. A është edhe dikush tjetër i cili dëshiron ta marrë fjalën? Jo. Atëherë do ta përmbyllim me një..

**VISAR HOXHA:** Faleminderit, kryetar!

Jam Visar Hoxha sekretar i kompanisë dhe menaxher i zyrës ligjore prej KOSTT-it. Kisha dashur ta përmend një çështje e cila indirekt u përmend këtu, është kërkesa e shtruarjes pronësore të operimit të transmisionit në Kosovë të cilat janë të transpozuar nga Neni 10 deri në Nenin 15 të Ligjit për Energjinë elektrike.

Këto kërkesa janë transpozim i direktivave të Bashkimit të Evropian për shtruarjen pronësore, përkatësisht nëse e themi me pak fjalë i bie që pronar i KOSTT-it apo ushtrimin e të drejtave të aksionarit të KOSTT-it dhe gjenerimit nuk mund ta bëjë i njëjti person. Këto janë reflektuar në Ligjin për Energji elektrike dhe në bazë të këtyre kërkesave KOSTT-i, u përmend se është certifikuar si operator i pavarur.

Ne në ndërkohë, para dy ose tre muajve jemi njoftuar për një projektligj i cili si duket është sponsoruar prej Qeverisë, për ndryshimin dhe harmonizimin e vijave të raportimit të agjencive të pavarura.

Ky projektligj nuk bën zgjidhje për harmonizim të vijave të raportimit, përkundrazi e kthen KOSTT-in në pozitën e para hyrjes në fuqi të Ligjit për Energjinë elektrike. Pra, nuk jep zgjidhje



të harmonizimit, por vetëm e kthen në kohë KOSTT-in para certifikimit. Ne si KOSTT, i kemi dërguar komentet. Nuk jemi kundër ndryshimit të vijave të raportimit, por kërkojmë që propozimet të jenë konkrete, specifike dhe të jenë në pajtim me kërkesat e direktivave të Bashkimit Evropian. Kjo, për arsye se nëse shkon ndonjë ligj ashtu, KOSTT-i nuk ka zgjidhje dhe mbetet në një situatë, e kemi thënë edhe në pozicione tona, në situatë të konfliktit të ligjeve. Faleminderit!

Kryesues, edhe një çështje nëse më lejon. Një shqetësim që ka pasur KOSTT-i edhe e ka paraqitur edhe publikisht, është projektligji apo ligji i miratuar për pagat në sektorin publik.

Është shqetësim shumë serioz i KOSTT-it për arsye se në krahasim me pjesët e tjera të sektorëve, me këtë ligj pagat në sektorin e energjisë elektrike, përkatësisht te KOSTT-i, zvogëlohen deri në 50%. Pra, kjo paraqet shqetësim serioz për ikjen e kuadrove kur dihen kërkesat në Bashkimin Evropian për kuadrot të profilit inxhinierik e posaçërisht specializime të KOSTT-it.

**KRYESUESI:** Faleminderit për mirëkuptimin. Sa për informacion edhe të publikut edhe të tuajin këtu, këtë çështje për me heq prej Ligjit të Pagave, e kam kërkuar unë personalisht si deputet dhe këtë vijë të argumentimit e kam mbrojtur aty meqë e kuptoj edhe rëndësinë e sektorit energjik, po gjithashtu edhe të sektorit të telekomunikimit.

Pra, inxhinierët më të mirë që i ka ky vend janë në institucione që merren me sektorin e energjisë dhe sektorin e telekomunikimit. Të njëjtën do tha thotë kryetarja për sektorin e minierave. Është votuar dhe është aprovuar njëherë dhe më pastaj është rikthyer në votim. Që ta keni parasysh, në votimin e dytë, deputetët kanë ndryshuar mendje dhe përsëri për pak vota, por kanë ndryshuar mendje.

Unë do të insistoj që me rishikim, nëse bëhet rishikim i këtij Ligji për Paga këtë vit, kjo çështje të trajtohet dhe të hiqen ndërmarrjet publike nga Ligji për Paga, sepse ndërmarrjet publike dhe institucionet e tilla nuk duhet të trajtohen me këtë ligj të pagave.

Këtë e kisha për ta sqaruar dhe shpjeguar se e kemi bërë këtë betejë në diskutim dhe do të vazhdojmë.

**SALA BERISHA-SHALA:** Faleminderit, kryesues i grupit punues!

Përshëndetje për të gjithë ju të pranishëm që jeni këtu. Përfaqësues të institucioneve të sektorit energjetik; ZRRE-ja, Ministria e Zhvillimit, KOSTT-i, KEDS-i, media dhe të gjithë ju të pranishëm.

Kërkoj falje që nuk kisha mundësi ngase isha e zënë me një agjendë tjetër dhe nuk munda të arrij me kohë.

Kemi konsideruar se ky dëgjim publik do të na sjellë më shumë palë të interesuara sepse për çdo ditë marrim ankesa dhe kërkesa sidomos të atyre operatorëve të cilët janë licencuar dhe nuk futen në treg siç e përmendi zoti Ajvazi nga ZRRE-ja.

Nuk e di se çka është folur që në fillim, sigurisht që edhe i ka përfshirë zoti Dardan Sejdiu, po qëllimi i dëgjimeve publike është të dëgjohen palët, sidomos kur ka të bëjë me monitorimin e ligjeve nga ana e Kuvendit. Pra, duhet të dëgjohen palët.

Nuk e kemi ndërmend dhe nuk është qëllimi që t'i zëmë ngushtë ose t'i vëmë para ndonjë akti të padëshirueshëm, por të shohim se sa po zbatohen ligjet. Sa Kuvendi po nxjerr ligje të cilat kanë për qëllim zhvillimin ekonomik dhe të mirën e qytetarëve.

Ne jemi përcaktuar që ta monitorojmë këtë ligj si komision parlamentar në mënyrë që t'i shohim...Me të vërtetë kemi probleme jo të vogla në sektorin e energjisë që janë të ndërlidhura me mekanizmat institucional. T'i shohim se mos funksionimi mirë i këtyre mekanizmave institucional mos ka të bëjë me infrastrukturën ligjore për çka jemi të thirrur ne që ta rregullojmë.

Nuk dëshiroj ta zgjasë shumë se ndoshta veç është shterur debati. Me vjen keq që nuk janë edhe të tjerët këtu dhe t'i ballafaqojmë argumentet në kuptimin e asaj se në qoftë se dikush është në vijën e zbatimit të ligjit, ndoshta dikujt tjetër nuk i duket se është pengesë ligji që të zhvillohet, qoftë si biznes, qoftë si sektor, por të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet që ju i kemi në lidhje me zbatimin e ligjit, nuk e di a e ka thënë që në fillim kolegu im Dardani, por t'i sillni me shkrim përmes administratës i cili e mbështet komisionin parlamentar.

Pastaj do t'i shohim bashkërisht se çfarë mund të bëjmë në këtë drejtim.

Ne e kemi përgatitur edhe një analizë përmes INDEP-it që dëshiroj ta përshëndes edhe IDNEP-in i cili e ka mbështetur komisionin në lidhje me zbatimin e Ligjit për Energjinë elektrike. Këtu janë disa të gjetura. Me të vërtetë është paradoksale kur zbatimi i këtij ligji, e para në kuptimin e asaj që liberalizimi i tregut, obligimet e shërbimit publik, të drejtat e konsumatorëve e të tjera, po besoj që janë diskutuar dhe janë shterur. Janë disa paradokse.

Ne si komision e kemi mbajtur një takim me aktorët e sektorit energjetik më herët dhe kemi sugjeruar që agjencitë e pavarura duhet ta ruajnë në mënyrë strikte pavarësinë e tyre, sipas mendimit tim, pavarësisht interferimeve të mekanizmave të tjerë.

Siç e përmendi edhe më herët një parafolës, ne kemi obligime kur jemi pjesë e mekanizmave ndërkombëtar. Marrim obligime dhe duhet si shtet të krijojmë në një imazh që ne i respektojmë ato obligime. Natyrisht, obligimet nganjëherë nuk i shkojnë shumë për shtati ambientit tonë në Kosovë, po bashkërisht duhet të angazhohemi të gjithë kudo që jemi, qoftë në Kuvend, qoftë në Qeveri, qoftë në institucione të pavarura dhe ta bëjmë më të mirën e mundshme.

Po i kthehem tash edhe shqetësimit që e ngritët rreth pavarësisë financiare të KOSTT-it dhe të ZRRE-së dhe të sektorit minerar edhe të tjera. Edhe unë personalisht kam qenë e pakënaqur me këtë pakon ligjore e cila ka ardhur për reformën në administratë.

Kosovës i duhet një reformë në administratë, po e kam shprehur edhe diku tjetër jo të fillohet reforma prej deformës, pra të çrregullohet diçka që është e rregulluar dhe është në harmoni edhe me kërkesat e Bashkimit Evropian dhe në harmoni me standardet që kërkohen prej nesh. Se sa kemi arritur të bëjmë lë për të dëshiruar.

Ligji për Paga hyn në fuqi diku në vjeshtë të këtij viti. Nuk besoj që do t'i nënshtrohet ndonjë rishqyrtimi në gjashtëmuorin e parë. Sidoqoftë, sidomos institucionet e pavarura duhet të jenë shumë aktive dhe proaktive kur e kemi fjalën në këtë drejtim dhe duhet ta fitojmë debatin publik sepse në Kuvend deputetët nuk vijnë si profesionistë. Nuk votojnë si profesionistë të fushave të ndryshme.

Deputetët votohen nga qytetarët dhe shpesh kur ka ndonjë tentativë, ka deputetë, ka edhe profesionistë siç e përmendi edhe Dardani, të fushës së energjisë, të ekonomisë edhe të minierave, është bukur vështirë të kuptohen nga deputetët tjerë deputetë, sepse diskutimet aty më tepër ndonjëherë për fat të keq orientohen më shumë në diskutime populiste sesa diskutim përmbajtjesor e që do duhej të ishte në fakt.

Kështu që kërkoj nga ju që këto ligje, nuk hyjnë në fuqi njëherë për njëherë, tani fillojnë me ligje specifike të rregullohet edhe çështja e rregullatorëve. Duhet të jeni shumë aktiv që përmes tryezave, përmes debateve de konferencave t'i ftoni ekspertët, t'i ftoni edhe deputetët, ndoshta edhe mund ta fitojmë debatin. Në të përgjithshme po flas. Faleminderit shumë për kohën tuaj!

Besojë do të bashkëpunojmë ngushtë dhe për çka do qoftë ne jemi këtu dhe bashkërisht mund ta bëjmë më të mirën e mundshme. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Kryetare, faleminderit shumë! Si gjithë kryetarja e shpjegon më së miri këtë angazhimin që e kemi dhe mundohemi ta kemi ne në komision. E para, ju falënderoj gjithashtu në emër të grupit punues për pjesëmarrje në këtë dëgjim publik.

Sa për informacion, ne i kemi ftuar të gjithë. Pra, të gjithë aktorët janë të informuar për diskutimin dhe dëgjimin që bëhet sot. Është vendim i secilit institucion apo palë se a do të jetë pjesëmarrës apo jo dhe është në diskrecionin e tyre ajo punë. Por, çfarë do të bëjmë ne, është që do ta dërgojmë këtë raport që e kemi marrë ne si komision, pra për nevojën të komisionit, të gjithë ju që jeni këtu prezent dhe për hir të një, le të themi kështu, bashkëpunimi që besoj që mund të jete pozitiv për sektorin, themi se sot i merrni në fund të orarit dhe deri sot një javë në fund të orarit na i dërgoni komentet me shkrim në çështjet që u ngritën këtu.

Ndërkohë, në se ka, atëherë mund të ulemi me secilin aktor si grup punues dhe t'i trajtojmë çështjet dhe në fund të bëjmë një raport të duhur e të mirë për komision, për Kuvendin e qe besa edhe për sektorin.

Për mua si informacion meqë edhe këtu po përmbyll, ky ligj ka hyrë në fuqi në gusht të vitit 2016 dhe jo rastësisht i kemi bregat çfarë i kemi, sepse po bëhen tri vite prej që ka hyrë ligji në fuqi.

Domosdoshmërisht, nëse ka pika të cilat nuk janë koherente me vendimet që po merren, e tha edhe përfaqësuesi i zyrës ligjore, atëherë të ulemi dhe të diskutojmë se çfarë duhet të bëjmë.

Për mua si sektor është me rëndësi për shkak të vendimeve që po merren e të cilat shpesh janë le të themi kështu, në kundërshti me frymën në të cilën e kemi shkruar ligjin në vitin 2016. Së paku leximi im.

Rrjedhimisht ju ftoj që t'i dërgoni komentet me shkrim dhe nëse ka nevojë të organizojmë edhe takime të secilës palë me grupin punues dhe t'i trajtojmë në detaje në mënyrë që edhe raporti të jetë përfshirës.

Unë kaq kam, nëse ka edhe dikush diçka mirë, nëse jo, atëherë ju falënderoj dhe ju uroj një ditë këndshme dhe besoj se do të bashkëpunojmë edhe në të ardhmen. Çdo të mirë!

**E përgatiti:**  
**Njësia për Transkriptim dhe Lekturë**